



Në bazë të dispozitave të nenit 8 të Ligjit të punës 03/L-212, Rregullore (QRK) Nr. 05/2022 për procedurat konkurruese dhe pranimi për nëpunësit administrativ dhe mbështetës, Statutit të Ndërmarrjes dhe rregulloreve të brendshme, Ndërmarrja Publike Lokale “Eko- Llapi” Sh.A. Podujevë shpallë këtë:

## **KONKURS**

**Për plotësimin e vendeve të lira të punës**

**Bagerist\e (Ekskavatorist\e)\ Kamionist\e- Një (1) pozitë**

**Titulli i Punës:** Bagerist\e (Ekskavatorist\e)\ Kamionist\e

**Raportimi:** Drejtuesit/es të njësisë operative

**Një (1) Pozitë:** Bagerist\e (Ekskavatorist\e)\ Kamionist\e

**Vendi i punës:** NPL “Eko-Llapi” Sh.A Podujevë

**Orari i punës:** 40 orë në javë

**Niveli i pagës:** 4

**Periudha provuese:** 6 muaj

### **Detyrat e përgjegjësitë:**

- a) Kryerja e detyrave të caktuara për bagerist dhe për mirëmbajtje e siguri të automjetit;
- b) Mbajtja e librit të shenimeve për kilometrazhin e automjeteve, të riparimeve, licensave dhe lejeve, si dhe dokumentacioneve të tjera;
- c) Përgjegjës për dëmet e shkaktuara me automjet nga pakujdesia apo mospërshtatja e rregullave të komunikacionit;
- d) Te jetë në gjendje ta lexoj projektin e punës;
- e) Të ketë përvojë së paku një (1) vit në vozitjen e kamionit;
- f) Është i obliguar të ketë sjellje korrekte duke respektuar kolegët;
- g) Detyra tjera relevante.

### **Aftësitë:**

- Shkathësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmoj fleksibilitet në punë;
- Njohje të shkëlqyer të materialeve dhe mjeteve të punës që kanë të bëjnë me pastrim;
- Të ketë kujdes të shtuar dhe të respektojë normat për sigurinë në punë;
- Të jetë i/e gatshëm/e të punojë në ambiente të ndryshme;
- Të jetë i/e gatshëm/e të punojë në të gjitha kushtet atmosferike;
- Të ketë etikë dhe integritet në punë.

### **Dokumentet e kërkuara :**

- Aplikacioni i NPL;
- Dëshmitë për Shkollim - Shkolla e Mesme;
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime nga Gjykata (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjen e patent shoferit (Kategoria C);
- Dëshmi mbi eksperiencën e punës së paku 1 vit (trusti).

## **Procedura e Konkurimit**

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyret e **NPL “Eko-Llapi” Sh.A Rr. “Zahir Pajaziti” Podujevë (Ish Objekti i Komunës ) Nr.19-Kati I**, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues. Dokumentacioni dorëzohet në **NPL “Eko-Llapi” Sh.A Rr. “Zahir Pajaziti” Podujevë (Ish Objekti I Komunës) Nr.19-Kati I**,

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistave kandidatët do të njoftohen përmes njoftimeve të cilat do të publikohen në web faqen e Komunës së Podujevës dhe në tabelën e shpalljeve në objektin e ish Komunës, pas mbylljes së konkursit

## **Sqarim:**

Fillimi i punës për pozitën e cekur më lartë, nuk do të jetë domosdoshmëri pas përfundimit të procedurave të rekrutimit të këtij konkursi por në vartësi të nevojave të Ndërmarrjes.

Aplikacionet dhe dokumentacioni i pakompletuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë shpallje si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.

**Kandidati/ja i/e përzgjedhur obligohet që para nënshkrimit të kontratës të sjellë çertifikatën mjekësore që është në gjendje të mirë shëndetësore si fizike ashtu dhe psikike.**

Shpallja është e hapur që nga data 05.06.2024 deri më 19.06.2024

NPL “Eko-Llapi” Sh.A Podujevë

